

# **‘KRYETARI I KOMUNËS –PËRFAQËSUES APO DOMINUES?’**

- NJË KONTRIBUT NË FORCIMIN E LLOGARIDHËNIES INSTITUCIONALE DHE  
TRANSPARENCËS NË NIVELIN LOKAL -

**Rasti i Kosovës**

**Autor:** Besnik Tahiri  
Drejtor Ekzekutiv  
Instituti Kosovar për Qeverisjes Lokale

Nëntor, 2012

## **Impressum**

Redaktor:

### **Friedrich-Ebert-Stiftung**

Zyra Editoriale:

#### **Friedrich-Ebert-Stiftung Zyra Prishtinë, Kosovë**

Rr.Mujo Ulqinaku 4/App 10

Tel: +381 38 243785, 220390

Fax: +381 38 220192

Email: [contact@fes-prishtina.org](mailto:contact@fes-prishtina.org)  
[ëëë.fes-prishtina.org](http://ëëë.fes-prishtina.org)

Radhitja:

#### **Studio FORMA**

Printimi dhe Prodhimi:

#### **Studio FORMA**

Dizajni Kopërtinës:

#### **Studio FORMA**

Date e printimit: Nëntor, 2012

Vendi i printimit: Prishtinë

**Të drejtat Autoriale:** Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale dhe Friedrich-Ebert-Stiftung

#### **Mohim:**

*Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk janë domosdoshmërisht ato të Friedrich-Ebert-Stiftung*

## Abstrakti

Në esencë, “publikimi synon të qartësojë pozicionimin e institucionit të kryetarit si institucion kyç në trekëndëshin, kryetar (ekzekutiv) - kuvend komunal (legjislativ) – qytetar (shoqërisë civile). Konstatimi i themelor i këtij publikimi është se roli i institucionit të kryetarit në sistemin e qeverisjes lokale në Republikën e Kosovës shtron nevojën për më shumë kontroll, baraspeshë dhe mbi të gjitha llogaridhënie të brendshme institucionale, si dhe kundrejt publikut. Publikimi argumenton se për shkak të rolit shumë të fuqishëm të institucionit të kryetarit në njërin anë, dhe në anën tjetër rolit pasiv të Kuvendit Komunal, i kombinuar me apatinë qytetare rezulton me shfaqjen e një deficiti demokratik shumë shqetësues për zhvillimet e qeverisjes lokale tani, dhe në të ardhmen.”

## **Përmbledhje Ekzekutive**

Një Qeveri lokale efektive dhe demokratike është absolutisht thelbësore për një Kosovë stabile dhe prosperuese. Katër vjet pas zbatimit të decentralizimit në Kosovës mund të konstatojmë se është bërë progres në rrafshin e pushtetit lokal dhe konsolidimit të komunave të vendit. Poashtu, si rrjedhojë e angazhimit institucional dhe punës së madhe dhe të përkushtuar të shumë njerëzve, korniza ligjore qeverisjes lokale ka përparuar dhe në të njëjtën kohë kemi një konsolidim të demokracisë së drejtpërdrejtë, që në esencë ka rritur kredencialet demokratike të vendit. Megjithatë, çështja e llogaridhënies dhe transparencës institucionale mbetet një çështje sfiduese e cila duhet të trajtohet menjëherë. Ky dokument argumenton se modeli i tanishëm i qeverisjes në nivel komunal po e ngadalëson synimin e demokracisë trajektore në Kosovë. Në mënyrë të veçantë, ky studim përshkruan se si dizajni institucional i qeverisjes lokale u ka mundësuar kryetarëve të komunave për të marrë një pozicion të dominimit që nuk është prirur nga fryma e ligjit, dhe nga dispozita të tjera ligjore. Dominimi i vazhdueshëm i kryetarëve të komunave dhe strukturave politike mbjell farën për një skenar të ardhshëm, ku mekanizmat e kontrollit dhe balancit të pushtetit janë të përçara më tej, dhe si pasojë çojnë në funksionalitet të dobët të pushtetit, mos koordinim të resurseve dhe të qeverisjes që jo domosdoshmërisht u shërben nevojave dhe pritjeve të qytetarëve.

Edhe pse kryetarët e komunave zgjidhen në mënyrë të drejtpërdrejt dhe se ky proces është demokratik, ky dokument vë në pikëpyetje nëse të njëjtit qeverisin në bazë të kësaj fryme. Në fakt, Kryetarët janë shndërruar në një autoritet dominues - me të gjitha kontradiktat që ky term nënkupton. Ata, pasi të zgjidhen, kanë tendencë të bëhen autoritet i dominimit në kuptimin që ata bëjnë përpjekje aktive për të përqendruar pushtetin në duart e tyre përmes një procesi politik që në fakt nuk është në linjë me vullnetin e popullit. Burimet e këtij defekti demokratik janë të ndryshëm. Kjo është kryesisht një çështje që ndërlidhet me projektimin e mangët institucional që vepron si një pengesë për një sistem të balancuar të qeverisjes. Në veçanti, këto mangësi lidhen me mungesën e mekanizmave institucionale që do të de-politizonin emërimin e drejtorëve komunalë dhe që do të siguronin fuqimisht funksionim të qeverisjes transparente dhe të përgjegjshme.

Kjo situatë mund të shpjegohet me mungesën e praktikave të dobishme dhe aranzhimeve të përcaktuara në mënyrë të qartë që do të sigurojnë llogaridhënien e kryetarëve të komunave në raport me vet qytetarët. Përveç kësaj, një kulturë e përgjithshme demokratike që do të mbajë kryetarin vazhdimisht në përgjegjësi të detyrës dhe do të kërkoj llogari është pothuajse jo-ekzistente, që do të thotë se pas përfundimit të cikleve zgjedhore, kryetarët mund të qeverisin pa marrë parasysh preferencat e qytetarëve. Pjesëmarrja zgjedhore dhe njohuritë e qytetarëve lidhur me mekanizmat e llogaridhënies mbeten shumë të ulëta dhe nga të njëjtit ka pak interes për

proceset e pjesëmarrjes në vendimmarrje. Kjo vjen si rrjedhojë se kryetarët në vazhdimësi po ngecin për të inkurajuar pjesëmarrjen e gjerë në komisione konsultative dhe duke marrë shumë pak informacion lidhur me rezultatet e debateve publike. Shumica e komunave nuk kanë krijuar mekanizma jo-formal të konsultimit me aktorë tjerë duke përfshirë shoqërinë civile. Zhvillimi i mekanizmave të kontrollit në nivel publik nuk është stimuluar sa duhet nga kryetarët të cilët mbajnë në dorë buxhetin për financimin e shoqërisë civile.

E fundit por jo edhe nga rëndësia, ky botim shpjegon dominimin e kryetarit, si rezultat i një kulture të pasivitetit që përshkon shumicën e kuvendeve (Asambletë Komunale) në nivel vendi. Mungesa e përgjegjësisë horizontale është përsëri një pikëpyetje e dizajnit (rregullimit) institucional. Kjo shpjegohet pasi që kuvendi komunal si institucion nuk ka linjë buxhetore, dhe në disa raste atyre ju mungojnë resurset themelore, duke përfshirë zyrat, pajisjet tjera të nevojshme për punë efikase dhe për të ushtruar përgjegjësitë e tyre. Pasiviteti është përkeqësuar nga një sistem të politikës partiake, që vënë besnikërinë ndaj partisë më lartë se reagimin ndaj nevojave të qytetarëve.

## Hyrje

Ky dokument mbulon zhvillimet në qeverinë lokale të Kosovës në periudhën prej Shtatorit 2011 - Shtator 2012<sup>1</sup>. Analiza është e bazuar në metodologjinë KLGJ-së e cila është rafinuar gjatë katër viteve të fundit të hulumtimit. Një strategji për grumbullimin e të dhënave të shumta është përdorur, duke përfshirë nxjerrjen nga hulumtimet në zyre, intervista nga terreni, grupe të fokusit të diskutimeve intensive që janë zhvilluar gjatë Akademisë së KLGJ-së për Qeverisje Lokale. Ky kapitull trajton çështjen e përgjegjësisë dhe transparencës dhe argumenton se një model i qeverisjes po shfaqet në nivelin komunal që ngadalson synimet e Kosovës për demokraci trajktore. Në mënyrë të veçantë, raporti përshkruan se si dizajni institucional i qeverisjes lokale u ka mundësuar kryetarëve për të marrë një pozicion të dominimit që nuk është pritur nga fryma e ligjit, dhe nga dispozita të tjera ligjore. Dominimi i vazhdueshëm për kryetarë të komunave të strukturave politike mbjell farën për një skenar të ardhshëm, në të cilin kontrollet dhe balancat e pushtetit janë të përçara më tej, dhe si pasojë çon në keqpërdorim të pushtetit, keqmenaxhim të resurseve dhe të qeverisjes që nuk shërbejnë nevojat dhe pritjet e saj qytetarët.

Pas theksimit të ndryshimeve të fundit në institucionin e kryetarit, ky dokument shpjegon pse janë shfaqur këto defekte demokratike, me një fokus të veçantë në marrëdhëniet e kryetarit me Kuvendin, shoqërinë civile dhe mediat si dhe diskutimi i funksionimit të dobët i procedurës për transparencë themelore dhe llogaridhënie. KLGJ argumenton që për të ndërprerë menjëherë këtë tendencë, ndryshime thelbësore duhet të bëhen dhe ky dokument përfundon me disa rekomandime në lidhje me rrugën përpara.

---

<sup>1</sup> Ekipi hulumtues i KLGJ-së për këtë periudhë ka qenë Besnik Tahiri, Fatmir Haxholli, Besnik Muçaj dhe Jahir Kelani. David Jackson gjithashtu ka kontribuar ide gjatë fazës së shkrimit.

## Konteksti

Në qershor 2008 Kosova ka miratuar Kushtetutën e saj e cila përfshin dispozita që rregullojnë vetëqeverisjen lokale sipas Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të Presidentit Ahtisari<sup>2</sup>. Lidhur me vetëqeverisjen lokale, "Propozimi" ka parashikuar kompetenca të zgjeruara për komunat në shumë fusha, duke përfshirë arsimin fillor dhe të mesëm, kujdesin primar dhe sekondar shëndetësor, zhvillimin ekonomik, planifikimin urban dhe rural, strehimin publik, emërtimin e rrugëve. Në mënyrë që të ushtrohen kompetencat në këto fusha dhe për të arritur objektivat që lidhen me to, Propozimi ka parashikuar transferimin e kompetencave të gjera legjislative, financiare dhe administrative

të komunave. "Propozimi" dhe marrëveshjet që dalin nga ky dokument - kushtetuta, ligjet, vendimet dhe aktet e tjera - kërkojnë që të mundësojnë zbatimin efektiv të parimeve të vetëqeverisjes lokale autonome. Në fushën e pushtetit lokal, të gjitha dispozitat e Propozimit të Ahtisaarit, dhe më vonë të Kushtetutës, sigurojnë një mjedis politik dhe ligjor që pasqyron dhe respekton parimet, proceset, procedurat, përvojat dhe praktikat e demokracive të përparuara perëndimore. Është e qartë se për më shumë se një dekadë të shtet-ndërtimit dhe konsolidimit të përgjithshëm të qeverisë së Kosovës, pushteti lokal, në veçanti, ka kaluar nëpër një tranzicion që është sfiduese si për kreatorët saj ashtu dhe për zbatuesit në të gjitha nivelet - politike, administrative, teknike ose operacionale.

Kundrejt këtij sfondi, është veçanërisht e rëndësishme të theksohet se sa i përket pushtetit lokal, institucionet qendrore të Kosovës dhe institucionet tjera nuk e kanë zgjidhur ende dhe adresuar çështjen e kontroleve dhe balancave të pushteteve. Është shqetësuese që në nivelin e pushtetit lokal komunat nuk e kanë gjetur ende mbështetjen e vërtetë dhe partneritetin nga institucionet qendrore dhe të tjera. Për më tepër, zhvillimet politike dhe qeveritare në nivel komunal janë shpesh të ndikuara nga zhvillimet në nivelet e tjera të qeverisjes, të cilat rrezikojnë autonominë dhe forcimin e pushtetit lokal. Gjithashtu duhet të përmendim faktin se nuk ka ekuilibër midis institucioneve brenda komunave. Për vite ne kemi qenë dëshmitarë se marrëdhëniet ndërmjet kuvendeve komunale dhe kryetarëve nuk pasqyrojnë mjaftueshëm dhe si duhet nevojën për një qeverisje të mirë, efikase dhe demokratike. Në mënyrë të veçantë, për një periudhë të caktuar kohe institucioni i kuvendit komunal ka dominuar vendimmarrjen, politikat dhe qeverisjen lokale, ndërsa institucioni i kryetarit të komunës ishte kryesisht në shërbim të zbatimit të këtyre vendimeve dhe politikave në nivel lokal.

---

<sup>2</sup> Propozimi mund të shkarkohet në: <http://www.unosek.org/unosek/en/statusproposal.html>

\* Për më shumë informacion, shih UNMIK-ut nr 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë

## **Dominimi i Kryetarit**

Sipas rregullores së mëparshme, Kuvendi Komunal ka zgjedhur një nga anëtarët e tij si kryetar të komunës në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë. Përgjegjësitë e Kryetarit të Kuvendit Komunal në atë kohë ishin të lidhura me mbikëqyrjen e përgjithshme të zbatimit të vendimeve që janë marrë nga Kuvendi Komunal dhe administrimin financiar të komunave. Kryetari ishte edhe kryetar i Komitetit për Politikë dhe Financa dhe kishte përgjegjësi të tjera që i janë dhënë atij/asaj sipas statutit. Kryetari i Komunës është mbështetur nga nënkryetarët, Kryeshefi Ekzekutiv dhe Bordi i Drejtorëve. \* Me pak fjalë, në bazë të rregullores së mëparshme, kryetari i komunës nuk ka qenë në gjendje të dominojë ose ti shmanget kuvendit komunal.

Por në katër vitet e fundit, vetëqeverisja lokale në Kosovë ka përjetuar disa ndryshime radikale. "Transformimi rrënjësor ka ndodhur në tri nivele, kompetencat (përgjegjësitë), riorganizimi dhe implementimi.<sup>3</sup>" Së pari, procesi i delegimit të kompetencave nga qendra në nivel lokal përmes procesit të decentralizimit dhe ligjeve të aplikueshme dhe kushtetutës, së dyti, nëpërmjet riorganizimit territorial, që është, krijimi i pesë komuna të reja dhe zgjerimin e komunës së Artanës (Novobërdës), dhe së treti, në vitet e fundit është shfaqur një boshllëk (hendek) midis asaj që është shkruar në letër dhe zbatimit të dobët në teren (praktik) pikërisht sepse nuk ka pasur një transferim të mjaftueshme të resurseve nga qendra.

Mungesa e pushtetit për vendim-marrje, pengesat dhe bllokada (për aq kohë sa Rregullorja e UNMIK-ut ishte i zbatueshme) që u përballën Kryetarët e Komunave çoi në forcimin e kryetarit në krahasim me Kuvendin Komunal, duke e bërë atë një institucion të veçantë nga Kuvendi dhe duke i dhënë atij fuqi të zgjeruara ekzekutive. Kjo ishte gjithashtu një rezultat i ndryshimeve dhe aranzhimeve që dalin nga propozimi i Ahtisaarit dhe inkorporimi i tyre në Kushtetutë dhe në veçanti, si rezultat i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Në këtë aspekt, ne shohim një transferim të kompetencave nga niveli qendror në atë lokal, duke përfshirë edhe ndryshimin e mënyrës se si zgjidhen kryetarët, nga sistemi i mëparshëm i UNMIK-ut, ku kryetari është zgjedhur nga Kuvendi, në situatën aktuale, ku kryetarët zgjidhen direkt nga qytetarët.

Gjatë tre vjet të studimeve, KLGJ ka treguar se publiku dhe vet qytetarët kanë një mendim pozitiv për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të kryetarëve të komunave, duke e parë atë si një metodë më demokratike, e cila i ka dhënë këtij institucioni një legjitimitet më të madh qytetar dhe demokratik. Në dallim nga Rregullorja e UNMIK-ut, objektivi kryesor i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale është që të balancojë fuqinë e institucioneve komunale, që është, në mes të kuvendeve komunale dhe kryetarëve. Më saktësisht, në njërin anë duke rezervuar për kuvendin komunal kompetenca të caktuara legjislative dhe vendim-marrëse ky ligj ka tentuar të ruajë kompetencat e kuvendit komunal, si përfaqësues i preferencave përgjithshme politike të komuniteteve dhe lokaliteteve në nivel komunal - përmes anëtarëve të kuvendeve komunale në

---

<sup>3</sup> Tahiri Besnik, Publikimi i Raportit: Blerësi misterioz në komunë. Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale, Mars, 2012.

organizimin politik brenda partive politike ose kandidatët e pavarur. Nga ana tjetër, duke siguruar për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të kryetarit të komunës, Ligji për Vetëqeverisjen Lokale nuk ka mundur të vendosë ose të nënshtroj këtë institucion nën kujdesin kuvendit komunal. Për kundrazi, është e kuptueshme se zgjedhja e drejtpërdrejtë e kryetarit ka akorduar kryetarët e komunave me atributet e vendimmarrjes që sigurojnë atij/asaj një autonomi të gjerë. Me këtë legjislacion, ekziston një dallim i qartë midis rolit të Kuvendit (pushteti legjislativ) dhe atij të kryetarit të komunës (pushteti ekzekutiv).

Aktualisht, roli i kryetarit të komunës është që vazhdimisht të autorizojë dhe mbikëqyrë ekzekutimin e vendimeve të marra nga ana e komunës dhe administrimin financiar të komunës. Kryetari i komunës, ndër të tjera, është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të vendimeve dhe akteve të miratuara nga kuvendi komunal dhe për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë e komunës në mënyrë të duhur. Ai ose ajo gjithashtu ka autoritetin për të përfaqësuar komunën dhe vepron në emër të saj. Shtrirja e përgjegjësive të kryetarit gjithashtu përfshin të drejtën për të nxjerrë udhëzime dhe në të njëjtën kohë të marrë vendime. Ligji për Vetëqeverisjen Lokale parasheh një sistem të kontrollit reciprok mes legjislativit (Kuvendit Komunal) dhe ekzekutivit (kryetarit të zgjedhur i komunës). Statuti Komunal duhet të përmbajë më shumë detaje mbi dispozitat që përcaktojnë rolin dhe fuqinë ligjore si dhe të përcaktojë saktë rolin e kryetarit të komunës në mbikëqyrjen dhe kontrollin e punës së administratës komunale. Në këtë drejtim, ka dy sfida serioze për këto dy institucione - kuvendin komunal dhe kryetarin.

Së pari, qeveria në përgjithësi, duke përfshirë edhe pushtetin lokal, janë formuar në një kontekst të ri të kulturës politike dhe institucionale të shtetit të 'porsalindur' dhe si pasojë e saj, praktika e mbajtjes së zyrtarëve qeveritarë në llogaridhënie është diçka e re. Është e njohur gjerësisht se demokracitë e konsoliduara kërkojnë shumë kohë dhe përpjekje për të arritur standardet, ku pushteti dhe përfaqësuesit e tij (politikanët, zyrtarët, shërbyesit civilë, etj) janë të mbikëqyrur, të kufizuar, të disiplinuar dhe nëse është e nevojshme, sanksionuar. Kjo kulturë politike, si dhe praktikatat që i nënkupton ky koncept po synohen në Kosovë, por jo në ritmin e dëshiruar. Së dyti, një tjetër sfidë është mungesa profesionale, veçanërisht ato menaxheriale dhe administrative, dhe si rezultat i kësaj, përfaqësues të caktuar në kuvend komunal dhe veçanërisht Kryetari i Komunës, do të përpiqen të kapërcejnë këtë boshllëk (dobësi) duke akumuluar pushtet që çon në dominim. Si pasojë, ne shohim se ka një "nënshttrim" të institucioneve dhe shkelje të mundshme të vullnetit të elektoratit dhe qytetarëve. E gjithë kjo po ndodh në një mjedis ku vendosja e sundimit të ligjit në Kosovë është ende një sfidë kombëtare, e cila duhet të zgjidhet në çdo nivel të institucioneve, shtetit dhe shoqërisë. Kosova është në gjendje relativisht të mirë sa i përket marrëveshjeve formale dhe ligjore, por kur shikojmë në praktikë, ne shohim shumë sfida dhe probleme serioze. Por të dhënat dhe zhvillimet në teren e konfirmojnë se krijimi i këtij dallimi në autoritetin dhe përgjegjësitë në mes të Kuvendit Komunal dhe kryetarit ka prodhuar pothuajse të kundërtën e qëllimit të synuar - në vend të arritjes së një ekuilibri të kontrollit të ndërsjellë kjo ka çuar në dominimin total të kryetarit të Komunës mbi Kuvendin Komunal, diçka që është



afirmuar shpesh nga raportet e auditimit zyrtar, si dhe studimet kërkimore të KLLGI në nivelin në teren.

Aktualisht, kryetari i komunës është duke akumuluar kompetenca nënshtrimi mbi kuvendin komunal dhe pjesëmarrësit e tjerë të shoqërisë civile dhe mediat. Roli i të cilëve, në vend të monitorimit, kontrollit dhe kufizimit, është bërë pothuajse inekzistent. Ekziston një shpjegim vendimtarë për këtë: Mungesa e linjave të ndara buxhetore për Kuvendin, shoqërinë civile dhe mediat. Kjo ilustron edhe me faktin se në shumicën e komunave ka një mungesë të resurseve, hapësirës së zyrës për kryetarët e kuvendeve komunale dhe grupet e kuvendit, ku ata mund të kryejnë përgjegjësitë e tyre dhe detyrat e dhëna atyre nga njerëzit<sup>4</sup>. Për më tepër, opozita është e abstrahuar për shkak se të gjitha interesat e njerëzve janë rreth organeve ekzekutive dhe kryetarit, dhe për rrjedhojë shoqëria civile shpesh është nën ndikimin e ekzekutivit për shkak të mungesës së mënyrave të pavarura të financimit.

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale parasheh kompetencat e Kuvendit Komunal dhe Komitetin për politikë dhe financa në hartimin e buxhetit komunal, përcaktimin e normave dhe taksave komunale e tarifave dhe zhvillimin e të gjitha planifikimit dhe marrjen e të gjitha vendimeve politike që ndikojnë në zhvillimin komunal.

### **Kryetari i Komunës vs Kuvendi Komunal**

Me forcimin e rolit të kryetarit, qeveria lokale në Kosovë ka mbetur pa mekanizma të kontrollit, pasi kuvendet komunale në shumicën e rasteve janë të përbëra nga një shumicë e cila vjen nga partia dhe koalicionet që kanë fituar zgjedhjet, por edhe në rastin e kundërt është e pamundur për të ushtruar ndonjë kontroll mbi kryetarin. Kjo shpjegohet me ndryshimin e statuteve në njëzet e tri komuna dhe nga rritja e numrit të departamenteve. Kjo rritje është bërë në mënyrë që të akomodohen partnerët politik që udhëheqin komunën pa i marrë në konsideratë dhe vlerësuar specifikat e komunës. Mungesa e debatit dhe bashkëpunimit midis akterëve vendimmarrës të zgjedhur drejtpërdrejt nga populli bën llogaridhënien të paqartë dhe shkakton huti në mesin e qytetarëve lidhur me përgjegjësitë institucionale, në këtë rast përgjegjësitë e Kuvendit dhe kryetarit të komunës.

Mungesa e traditës institucionale ka lënë hapësirë për mekanizmat e partisë për të ndërhyrë në punën e komunave. Kryetari i komunës në të shumtën e rasteve ka dy adresa të llogaridhënies, një të subjektit që e ka nominuar atë dhe tjetra qytetarëve siç është përcaktuar me ligj. Megjithatë, një nga adresat e llogaridhënies, pra, të qytetarëve, është shumë e dobët sepse shumica e ideve të shprehura nga qytetarët në debatet publike asnjëherë nuk janë ndjekur, që do të thotë se kryetarët e komunave organizojnë takime të tilla publike vetëm për të përmbushur një kërkesë formale. Adresa e vërtetë e llogaridhënies në praktikë është partia që ai ose ajo

---

<sup>4</sup> Tahiri Besnik; Minutat e takimit të programit “Akademia për Qeverisje Lokale”; Marrëdhëniet në mes të të zgjedhurve politikë (Kryetarit) dhe shërbyesve civilë (administratës komunale); Hotel Sirius, Prishtinë; dhjetor 2011

përfaqëson dhe që është kthyer në një adresë të detyrimeve që kryetari ka për të përmbushur gjatë mandatit të tij/saj. Kjo shpjegohet me faktin se në shumicën e komunave Kryetarët janë zakonisht kryetarët e degëve të partisë.

Kjo dobësi në llogaridhënien dhe përmbushjen e kërkesave ligjore ndaj qytetarëve mund të kontrollohet nga mundësia e shkarkimit të kryetarit, e cila në këtë rast nuk mund të bëhet nga kuvendi komunal, edhe pse përfaqësuesit e këtij institucioni janë të zgjedhur drejtpërdrejt nga populli. Gjithashtu, fakti që një thirrje për shkarkimin e një kryetari kërkon 50% të votave të të gjithë votuesve të mundshëm në komunë e bën largimin nga detyra të kryetarit të komunës nga qytetarët gati e pamundur, sidomos duke pasur parasysh pjesëmarrjen e ulët në përgjithësi në zgjedhje<sup>5</sup>. Bazuar në atë që u tha më lart, mund të ndodhë, siç u tha nga drejtori ekzekutiv i Institutit të Kosovës për Pushtetit Lokal se "kryetari i komunës ka potencial për t'u bërë një" monark ": një person i paprekshëm gjatë mandatit të tij në Komuna".<sup>6</sup>

Gjithashtu duhet të theksohet se ka një perceptim të gjerë në mesin e qytetarëve që institucioni i kryetarit të komunës është institucioni më i fuqishëm në komunë. Sipas një sondazhi të organizuar nga BIRN, 73% e qytetarëve janë përgjigjur në pyetjen që ata u pyetën se kryetari është autoriteti më i fuqishëm në komunë<sup>7</sup>.

Dualizmi dhe paqartësia në zbatimin e përgjegjësive dhe kompetencave në shumicën e rasteve është një pengesë për arritjen e funksionalitetit dhe efikasitetit më të madh në ofrimin e shërbimeve. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, përveç përgjegjësisë për të krijuar dhe harmonizuar kornizën ligjore, nuk mund të luajë rolin e "policit" që përherë të kontrolloj komunat, sepse autonomia e komunave është e garantuar. Në raste të veçanta, kur kemi të bëjmë me mungesën e legjislacionit është e rëndësishme të kujtojmë parimet e Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale, e cila vjen nga Këshilli i Evropës, një komunitet politik që Kosova aspiron ti bashkohet. Karta, inter alia, deklaron të drejtën e vetëqeverisjes lokale, në mënyrë që të rregullojë dhe menaxhojë një pjesë të konsiderueshme të çështjeve publike për të mirën e popullit, "duhet të ushtrohet nga këshillat ose kuvendet të cilat mund të kenë nën mbikëqyrje të tyre autoritetet ekzekutive që do tu raportojnë<sup>8</sup>."

Në këtë drejtim, duket se Kuvendi Komunal edhe pse është menduar të jetë përfaqësuesi më i lartë në nivel lokal, në realitet dhe praktikë ai është Kryetari i Komunës i cili dominon qeverinë

---

<sup>5</sup> Për më shumë informacion mbi mundësinë për shkarkimin e kryetarit të komunës parë Ligjit nr 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Neni 72 - Shkarkimi i kryetarit të komunës, në [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L040\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L040_al.pdf)

<sup>6</sup> <http://rtv21.tv/home/?p=3837>

<sup>7</sup> Raport mbi Studimin e pushtetit lokal vetëqeverisjes në Kosovë, sistemi i zgjedhjes së drejtpërdrejtë të kryetarit të pushtetit lokal; BIRN, mars 2011

<sup>8</sup> Neni 3.2 i Kartës Evropiane për Vetëqeverisje lokale

lokale. Në bazë të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, Kuvendi Komunal ka organe të mjaftueshme që mundën vetë të organizojnë, mbikëqyrin, korrigjojnë ose promovojnë qeverinë lokale. Organet e Kuvendit Komunal të tilla si plenare dhe komitetet, takohen rregullisht të paktën dhjetë herë në vit për të miratuar legjislacionin komunal dhe për të diskutuar çështje me interes për komunën. Kuvendi i komunës funksionon në bazë të ligjeve, siç është Ligji për Vetëqeverisjen Lokale dhe Ligji për Financat e Pushtetit Lokal dhe statuti komunal, si dhe aktet e tjera normative.

Është gjithashtu e rëndësishme të përmendet se dominimi i Kryetarit gjithashtu buron nga roli pasiv i anëtarëve të kuvendit të komunës. Këta të fundit, për arsye të ndryshme, të gjejnë të vështirë për të krijuar lidhje të forta me qytetarët. Komunitat, ndër të tjera, nuk u japin grupeve ose anëtarëve të kuvendit ndonjë objekt ose zyrtar me adresë të përhershme ku ata do të jenë në gjendje të punojnë dhe ku qytetarët mund të kontaktojnë ose të takohen me ta. Kjo është e lidhur me arsye të tjera, duke filluar nga momenti i paraqitjes së kandidaturës për anëtarët e kuvendeve komunale deri te kompensimi i tyre adekuat.

Një tregues i qartë i dobësisë tillë e rolit të anëtarëve të kuvendit të komunës vjen nga raporti i OSBE-së 2011 i cila konstaton se në pothuajse gjysmën e komunave të vlerësuara, ekziston një dështim për të informuar publikun në lidhje me mbledhjet e kuvendit komunal, dhe dështimi për të sensibilizuar publikun për çështjet që janë adresuar, kryesisht për shkak të faktit se zyrtarëve për informim u mungojnë kapacitete të mjaftueshme për të kryer punën e tyre në mënyrë efektive. Dështimi për të lehtësuar qasjen publikut të gjerë në proceset vendim-marrëse pengon përpjekjet e institucioneve komunale për të qeverisur në një mënyrë transparente, që paraqet një shkelje të parimeve të qeverisjes së mirë të përcaktuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale<sup>9</sup>. Një tjetër pengesë është fakti se përkthim simultan gjatë takimeve të asamblesë komunale është pothuajse gjithmonë i siguruar nga komunitat sipas kërkesës. Por, përkthimi i materialeve për mbledhjet e kuvendit komunal nuk është dhënë fare nga 52 për qind të komunave që ishin të vlerësuara<sup>10</sup>.

---

<sup>9</sup> Raporti i monitorimit komunal, OSBE-së, qershor 2012

<sup>10</sup> Raporti i njëjtë

## **Kryetari administron administratën**

Kjo tingëllon si një paradoks, por të dhënat nga terreni kanë konfirmuar se ka raste kur kryetarët e komunave, në vend se të ndihmojnë në përparimin e punës së administratës komunale, ata kanë penguar atë duke ndërhyrë në proceset administrative.

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe aktet e tjera rregullatorë, administrata komunale është e organizuar në departamente (drejtori). Çdo departament komunal menaxhohet nga drejtori i cili emërohet dhe shkarkohet nga kryetari. Drejtorët menaxhojnë dhe drejtojnë departamentet e tyre në përputhje me udhëzimet strategjike dhe politike të kryetarit të komunës dhe raportojnë te kryetarit të komunës në baza të rregullta për çështjet që janë nën kompetencat e tyre. Drejtorët i raportojnë rregullisht kryetarit për çështjet nën kompetencën e tyre dhe i japin atij të gjitha informatat dhe raportet që janë të nevojshme në procesin e vendimmarrjes.<sup>11</sup>

Por në të njëjtën kohë ekziston kjo praktikë ku drejtorët janë të emëruar nga Kryetari i Komunës, e që në shumicën e rasteve emërimet e tilla janë plotësisht të shtyra politikisht (dhe shpesh pa kritere). Kjo jo vetëm që shkakton mungesa në zhvillimin e departamentit përkatës, por gjithashtu shkakton tensione në marrëdhëniet ndërmjet stafit civil dhe drejtorëve. Kontrolli i drejtpërdrejtë politik i stafit civil është i dëmshëm për zhvillimin e stafit civil të bazuar në meritokraci dhe promovim, siç është paraparë në bazë të Ligjit mbi Shërbimin Civil. Mungesa e harmonizimit të duhur në mes të vizionit politik dhe administratës gjithashtu shkakton dështime në ofrimin e shërbimeve për qytetarët, prandaj komitetet sektoriale duhet të rekrutojnë njerëz profesional për të forcuar politikat.

Zyrtarët e MAPL-në në një takim të programit "Akademia për Qeverisje Lokale", me temë "Marrëdhëniet mes njerëzve të zgjedhur politikisht (kryetarët) dhe nëpunësve civilë (administrata komunale), 'me të drejtë përcaktoj se' gjatë hartimit të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ka pasur disa mendime që drejtorët komunal duhet të jenë nëpunës civilë, por e ka ndodhur kundërta<sup>12</sup>. Në vlerësojmë se emërimi politik i drejtorëve ka shtyrë që ata shumicën e kohës së tyre në angazhimet politike, sidomos në kohën e fushatave kur komunat janë pothuajse bosh. Aktualisht, vlerësohet të jetë pozitive që shefi i personelit është drejtpërdrejt përgjegjës para kryetarit të komunës, por në të njëjtën kohë Kuvendi Komunal nuk është në gjendje të ushtrojë mbikëqyrje të vazhdueshme mbi administratën komunale, pasi që kryetari zgjidhet drejtpërdrejt dhe vendos në mënyrë të pavarur se kush duhet të jenë të emëruarit e i tij/saj në ekzekutiv. Ndërsa, zëvendësministri i Pushtetit Lokal, në një debat mbi Projekt-Strategjinë e Pushtetit Lokal 2013-2016 deklaroi: "Kryetarit të Komunës i është dhënë e drejta për të emëruar drejtorët dhe prandaj varet prej kryetarit të komunës se këndë do ta emërojë ose jo si drejtor. "

<sup>11</sup> Ligji për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr 03/L-040), Kapitulli VI, neni 62; Drejtori Komunal

<sup>12</sup> Procesverbali i mbledhjes së programit "Akademisë mbi Vetëqeverisjen"; Marrëdhënia në mes të njerëzve të zgjedhur politikisht (Kryetari) dhe nëpunësve civilë (administrata komunale), Hotel Sirius në Prishtinë, dhjetor 2011

Edhe pse kjo nuk është në mënyrë rigorozë kundër ligjit, ekziston edhe një perceptim publik që drejtorët vazhdojnë të emërohen në bazë të kriterëve politike. Sipas një studimi të BIRN-it, 63.4% e të anketuarve u përgjigjën se drejtorët emërohen mbi baza politike<sup>13</sup>. Një raport i gazetës "Jeta në Kosovë" mbi situatën në fushën e arsimit tregon se edhe emërimi i drejtorëve të shkollave është i ngjashëm me emërimin e drejtorëve të departamenteve. Sipas botimit BIRN, "fenomeni është si një rreth, pasi drejtorët e shkollave janë edhe menaxherë të qendrave të votimit, siç ishte rasti në zgjedhjet e fundit nacionale, pra partitë në nivel lokal emërojnë udhëheqësit e degëve të tyre dhe aktivistët si drejtorët të shkollave"<sup>14</sup>.

Ndërsa, si ne mësojmë nga praktikat ndërkombëtare të përmendura nga Profesor Ita O'Donovan, profesionistët dhe nëpunësit civilë luajnë një rol të rëndësishëm, siç është rasti me zyrtarin buxhetor dhe financiar (drejtor i financave) dhe oficerë të thesarit. Fuqia shtrihet në të dy anët, mbi nëpunësit civilë dhe politikanët që kanë role të rëndësishme në punën e tyre, por është e rëndësishme për nëpunësit civilë të kuptojnë qartë se ata duhet të zbatojnë politika dhe politikanët që ata duhet të respektojnë procedurat administrative dhe rregullat e shërbimit civil<sup>15</sup>. Në fakt, në shumicën e komunave po ndodh e kundërta; hulumtimi në terren nga KLGJ ka gjetur se politikanët po inkurajojnë stafin civil të mos respektojnë procedurat, rregullat dhe ligjin në përgjithësi, ndërsa këta të fundit për shkak të qëndrimeve të tyre politike shpesh janë përfshirë në mënyrë aktive në politikë. Lidhur me detyrimet që drejtorët e departamenteve kanë për të bashkëpunuar dhe draft rregulloret me kuvendet komunale, në shumë raste drejtorët e departamenteve kanë ndërhyrë në punën e kuvendeve komunale, e cila është treguar në monitorimin e raporteve të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal të vitit 2011<sup>16</sup>.

Ndërsa raporti mbi transparencën e pushtetit lokal në Prizren i zhvilluar nga Organizata EC MA NDRYSHE shpjegon se një nga veprimet më kontradiktore dhe më dëmtuese për demokracinë lokale, e ndërmarrë gjatë mandatit të kryetarëve Aktual të komunave është mbyllja e takimeve mes Kryetarit të Komunës me drejtorët (më parë Bordin i Drejtorëve) për publikun. Askush nuk ka dhënë ndonjëherë ndonjë arsye të qartë dhe bindëse për një mbyllje të tillë prej kur është marrë njëmendim i tillë. Kjo praktikë, e cila është shpesh kontradiktore me parimet themelore të qeverisjes transparente, është dëshmi se komuna e Prizrenit ka dështuar në promovimin e standardeve të qeverisjes së mirë.

---

<sup>13</sup> Raporti Hulumtues mbi pushtetin lokal në Kosovë: Sistemi i zgjedhjes së drejtpërdrejtë të kryetarit të pushtetit lokal - BIRN, mars 2011

<sup>14</sup> Raporti i Organizatës BIRN

<sup>15</sup> O'Donovan Ita; Procesverbali i mbledhjes së programit "Akademi mbi Vetëqeverisjen"; marrëdhënien ndërmjet nëpunësve të zgjedhur politikisht (Kryetari) dhe civile (administrata komunale), Hotel Sirius në Prishtinë, dhjetor 2011

<sup>16</sup> <http://mapl.rks-gov.net/getattachment/83a0b0ee-0ed7-40d5-a5b0-614f4560acc/Raporti-Janar-Qershor-2011.aspx>

## Kryetari i Komunës dhe akterë të tjerë - shoqëria civile, media

Përmes organizatave të shoqërisë civile aktive në komunë, institucionet lokale të vetëqeverisjes kanë mundësi më të mëdha se sa qeveria qendrore (Ministria përkatëse) për të monitoruar zbatimin dhe ndikimin e shpenzimeve publike. Por, duhet përmendur se roli i planifikimit strategjik në nivel vendi është kryesisht një ushtrim që përshkruan situatën se sa të ofrojnë zgjidhje apo vizion zhvillimor. Në mungesë të vizionit të tillë, qeveria lokale është e pozicionuar në kufijtë e ligjit, për të qenë më të saktë, ata duhet "të shkojnë përtej strukturës"<sup>17</sup>. Kjo do të thotë se ata duhet të shkojnë përtej detyrave funksionale të tyre administrative dhe të jenë më pro-aktiv në krijimin dhe zbatimin e një plani të fortë të zhvillimit që mund të përmirësojë jetën e qytetarëve të tyre. Efektiviteti është i lidhur me vlerësimin e politikave që janë zbatuar dhe suksesin e zbatimit të tyre nga administrata. Kjo do të thotë se demokracia dhe qeveria lokale nuk është vetëm ajo që është shkruar në Kushtetutë dhe ligje, por ajo duhet të shkojë më tej dhe përtej kornizave administrative. Ajo kërkon shumë punë dhe angazhim, por zhvillimi i strategjive që duken të mira në fushata të marrëdhënieve publike nuk janë të mjaftueshme, ato duhet të pasohen me veprime konkrete në praktikë. Në një fjalim të Prof. Donald Courtis për drejtorët e departamenteve komunal një parim i rëndësishëm është shprehur: "Kur mendohet për interesin e qytetarëve, është e rëndësishme që të veprohet përtej asaj që jeni dhe atë që ju mund të jepni për shoqërinë."<sup>18</sup>

Një tjetër aspekt i rëndësishëm është që të mbahet parimi i subsidiaritetit dhe llogaridhënia lokale për mobilizimin e resurseve lokale, përfshirja e drejtpërdrejtë e qytetarëve në proceset vendim marrëse partneritet, dhe bashkë-sigurimin e shërbimeve. Gjithashtu duhet të kuptohet se rritja e rolit të pushtetit vendor ka ndryshuar konceptin e zhvillimit i cili tani kërkon shumë më tepër angazhim dhe ekspertizë<sup>19</sup>. Ligji për Vetëqeverisjen Lokale ka parashikuar themelimin e Komiteteve Konsultative Komunale, por ato kanë mbetur ose të paefektshëm ose jo funksional në këtë fushë. Për më tepër, ka prova të pakta se Kryetarët e komunave kanë thirrur forume të tilla konsultative për të rritur nivelin e komunikimit dhe transparencës dhe për të forcuar koordinimin në zhvillimin ekonomik lokal.

Në ceremoninë e mbylljes për gjeneratën e parë të Akademisë së Qeverisje Lokale, drejtori ekzekutiv i KLGJ deklaroi se "është koha për një reformë të plotë të pushtetit lokal në Kosovë, dhe debati në komunat duhet të kthehet në drejtim të zhvillimit ekonomik, sepse progresi mund të arrihet vetëm atëherë kur ne do të fokusohemi. Kjo do të kërkojë komunikim efektiv dhe pa pengesa me bizneset dhe qytetarët."<sup>20</sup> Kryetarët e Komunave kanë mbetur gjithmonë brenda

---

<sup>17</sup> Courtis Donald, Procesverbal i mbledhjes së programit "Akademi mbi Vetëqeverisjen" - Decentralizimi rishqyrtohet; zbulimi i rrezikut moral dhe gjetja e opsioneve, qeveria lokale dhe sociale kompaktësia, Hotel Sirius në Prishtinë, Maj 2012

<sup>18</sup> I njëjtë

<sup>19</sup> I njëjtë.

<sup>20</sup> <http://ëëë.kosovaitimes.net/?page=1,17,8212>

kornizës së obligimeve ligjore dhe kurrë nuk kanë arritur të kalojnë strukturën dhe modelin për të mirën e të gjithëve. Ne kemi rastin e takimeve të komunës së qytetit të cilat vijnë duke dështuar edhe më shumë, por ende vazhdojnë të mbeten një detyrim ligjor, dhe si pasojë njerëzit nuk besojnë më se takime të tilla do të japin rezultate dhe ne shohim një pjesëmarrje gjithnjë e në rënie.

Në këtë drejtim, Kryetarët e Komunave nuk ka mund të gjejnë një mënyrë më të mirë për të organizuar takime të tilla edhe pse ka pasur sugjerime në disa komuna nga ana e shoqërisë civile që duhet të jetë shoqëria civile që merr përgjegjësinë, e që nuk u pranua nga kryetarët e komunave, dhe kështu takimet vazhdojnë të organizohen në mes të zyrtarëve komunalë, drejtorëve dhe një numri shumë të vogël të qytetarëve.

Themelimi i komiteteve konsultative është një nga kërkesat që rrjedhin nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka lëshuar Udhëzimin Administrativ për Komitete Konsultative në mënyrë që qytetarët dhe grupet tjera të interesit të jenë pjesë e procesit të vendim-marrjes lokale, por deri tani ky mekanizëm i një përfshirje të gjerë të ekspertëve dhe qytetarëve në vendimmarrje nuk është aplikuar gjerësisht. Kjo tregohet në raportin për transparencën e pushtetit lokal të Prizrenit nga ana e organizatës EC MA NDRYSHE i cili thotë se deri më tani, komuna e Prizrenit ka vërtetuar të jetë shumë e ngathët në themelimin e komiteteve konsultative. Në të njëjtën kohë, kjo organizatë vlerëson se asnjë interes nuk është vërejtur në mesin e qytetarëve dhe shoqërisë civile për të përdorur këtë mekanizëm të vendimmarrjes qytetare<sup>21</sup>.

OJQ "Shtëpia Jonë" gjithashtu thekson se në komunën e Novobërdës, shoqëria civile nuk ka arritur të mobilizohet si duhet dhe krijimi i komiteteve konsultative është një masë e nevojshme, por në të njëjtën kohë është e nevojshme që të ketë një koordinim dhe bashkëpunim me gjithë shoqërinë civile të komunës së Novobërdës<sup>22</sup>. Në mënyrë për të lehtësuar punën dhe për të siguruar komunikim me të gjithë qytetarët, komisionet lokale duhet të forcohen, ndërsa themelimi i tyre duhet të vendoset nëpërmjet konsultimeve të gjera me qytetarë.

Drejtori i D-Press në seminarin për iniciimin e themelimit të Komiteteve Lokale tha se "forcimi i komiteteve lokale do të ketë një ndikim në përmirësimin e qeverisjes komunale, përdërisa funksionimi i komiteteve këtilla lokale do të mobilizojë njerëzit lokal në përpjekjet e të gjithë aktorëve për të përmirësuar jetën në fshatra por edhe në lagje urbane<sup>23</sup> "

---

<sup>21</sup> [http://www.ecmandryshe.org/repository/docs/EC\\_Transparenca\\_lokale\\_ne\\_Prizren.pdf](http://www.ecmandryshe.org/repository/docs/EC_Transparenca_lokale_ne_Prizren.pdf)

<sup>22</sup> <http://rajonipress.com/shfleto-artikujt.php?id=444>

<sup>23</sup> <http://www.kosovaitimes.net/?page=1.3.1522>

Drejtori ekzekutiv i Institutit të Kosovës për Pushtet Lokal duke folur për rëndësinë e komiteteve lokale, për një përfaqësim më gjithëpërfshirës të gjithë qytetarëve dhe për forcimin e demokracisë, deklaroi se "Ne kemi parë se në qytete ka zyra ku njerëzit mund të paraqesin kërkesat dhe idetë e tyre , por ne shpesh harrojmë se më shumë se gjysma e popullsisë jeton në fshatra ku nuk ka zyra të tilla. Në këtë drejtim, unë mendoj se organizimi përmes komiteteve lokale në nivelin e qeverisjes vendore do të ndihmojë në planifikimin e buxhetit, investimet kapitale, por gjithashtu do të rrisë përgjegjshmërinë dhe do të sigurojë një shpërndarje më të balancuar të projekteve <sup>24</sup>".

Subvencionimi i OJQ-ve dhe shoqërisë civile në përgjithësi nuk siguron punën objektive nga ana e shoqërisë civile dhe kërcënon pavarësinë e saj. Certifikimi i qendrave rinore komunale si institucionet e përfaqësuesve të rinjve nga Departamenti Komunal për Kulturë, Rini dhe Sport me miratimin e kryetarit, në mënyrë të qartë shpjegon ndërhyrjen e tij/saj në këtë fushë dhe paaftësinë e të rinjve për t'u përfaqësuar jashtë 'vijës' së tij/ saj. Kjo ka rezultuar në politizimin ekstrem të OJQ-ve në komuna.

Për më tepër, rregulloret që komunat kanë për subvencione u japin fuqinë kryetarëve që të japin subvencione deri në shumën prej 1000 euro, dhe nuk kufizon numrin e tyre ose shpeshësinë e subvencioneve të tilla për subjekte të caktuara, dhe atij/asaj i është mundësuar gjithashtu të miratojë kërkesat e arsyeshme, të cilat në varësi nga shumat duhet të vendosen ose nga Komisioni për Politikë dhe Financa ose Kuvendin e Komunës. Kjo formë e rregullimit të subvencioneve siguron kryetarin me mundësi për të kontrolluar shoqërinë civile.

### **Kryetarët: tërheqja e qytetarëve më afër qeverisë ose shtyrja e tyre më larg?**

Transparenca dhe llogaridhënia janë dy parime themelore për funksionimin e komunës në një mënyrë demokratike dhe të përgjegjshme dhe për të mirën e qytetarëve të saj. Në këtë dokument, Instituti i Kosovës për Qeverisje Lokale do të paraqesë nivelin e komunikimit me qytetarët, marrëdhëniet publike dhe nivelin e cilësisë së takimeve me qytetarët, mediat dhe shoqërinë civile. Në fakt, kjo mbulon qeverisjen nëpërmjet informacionit, konsultimit, pjesëmarrjes së qytetarëve dhe akterëve të tjerë në nivel lokal dhe më të gjerë. Në këtë drejtim, transparenca dhe llogaridhënia ndikon në konsolidimin demokratik në nivel lokal, por edhe forcon lidhjen në mes të të zgjedhurve/strukturave qeverisëse dhe përbërësve/qytetarëve. Një qeveri demokratike parashih praktikat dhe proceset që sigurojnë se strukturat e qeverisë nuk janë të shkëputura nga, dëshirat shqetësimet dhe pritjet e qytetarëve.

Organizata D-Press dhe Instituti Kosovar për Pushtet Lokal dhe pjesëmarrësit në seminarin

---

<sup>24</sup> I njëjtë



"Rruga drejt informatave publike efikase", arriti në përfundimin se transparenca dhe llogaridhënia duhet të jetë baza e qeverisjes së mirë dhe komunikimi efektiv me qytetarët dhe pjesëmarrja e tyre në zhvillimin dhe zbatimin e politikave të komunës është vendimtare. Për këtë qëllim, është obligim i Kryetarit të informojë dhe të raportojë në baza të rregullta në lidhje me punën dhe aktivitetet në komunë.

### **Roli dhe funksioni i Zyrave të Informacionit**

Një segment i rëndësishëm për funksionimin normal dhe efikas të institucioneve legjitime dhe demokratike të dala nga vota e lirë e qytetarëve janë Zyrat Komunale për Komunikim dhe Informacion, të cilat për fat të keq deri më sot nuk janë konsoliduar dhe funksionalizuar siç duhet, as sa i përket pajimit të tyre me mjete konkrete e as me kërkesën për staf profesional.

Krijimi i Zyrave Komunale për Komunikim e Informacion është i bazuar në nevojën dhe detyrën parësore për të informuar qytetarët mbi një punë në baza të rregullta dhe efikase- lidhur me punën e autoriteteve qeverisëse komunale për të ndihmuar autoritetet e tilla të jenë transparente në punën e tyre, si dhe të informojnë njerëzit rreth punës së institucioneve tjera që janë të menaxhuara nga qeveria lokale, rreth ngjarjeve dhe zhvillimeve të tjera në komunë apo në lidhje me komunën.

